



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 18.02.2014, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Arta Dade – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.
2. Projektligji “Për ratifikimin e instrumenteve që ndryshojnë Kushtetutën dhe Konventën e Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacioneve (Gjenevë, 1992), të ndryshuar nga Konferenca Fuqiplotë (Guadalajara, 2010)”.
3. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së kredisë për eksport, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë dhe përfaqësohet nga Ministria e Financave, dhe Unicredit Bank Austria A.G. për financimin e projektit mbarëkombëtar të radioterapisë”.
4. Projektligji “Për ratifikimin e dokumentit të ndryshimit nr. 1, të marrëveshjes së kredisë për eksport, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, që vepron në

emër të Republikës së Shqipërisë e përfaqësohet nga Ministria e Financave dhe Unicredit Bank Austria A.G. për financimin e projektit mbarëkombëtar të radioterapisë”.

Marrin pjesë:

Arta Dade, Aldo Bumçi, Namik Dokle, Gramoz Ruci, Valentina Leskaj, Vangjel Dule, Eduard Selami, , Kastriot Islami, Fatmir Mediu.

Mungojnë:

Ben Blushi, Jozefina Topalli, Gerti Bogdani, Shpëtim Idrizi, Olta Xhaçka, Përparim Spahiu.

Të ftuar:

Zj. Milva Ekonomi, zëvendës ministre, Ministria e Shëndetësisë

Z. Armand Shandro, Specialist në Drejtorinë e Traktateve dhe të Drejtës Ndërkombëtare në Ministrinë e Punëve të Jashtme

Zj. Elona Mistrovica, Specialiste ne Drejtorinë e Drejtimit te Borxhit Publik, Ministria e Financave

Zj. Irena Malolli, Drejtore e Komunikimeve Elektronike e Postare, pranë AKSHI

HAPET MBLEDHJA

Arta Dade – Të nderuar kolegë, hapim mbledhjen e radhës me këtë rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.
2. Projektligji “Për ratifikimin e instrumenteve që ndryshojnë Kushtetutën dhe Konventën e Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacioneve (Gjenevë, 1992), të ndryshuar nga Konferenca Fuqiplotë (Guadalajara, 2010)”.
3. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së kredisë për eksport, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë dhe përfaqësohet nga Ministria e Financave, dhe Unicredit Bank Austria A.G. për financimin e projektit mbarëkombëtar të radioterapisë”.

4. Projektligji “Për ratifikimin e dokumentit të ndryshimit nr. 1, të marrëveshjes së kredisë për eksport, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë e përfaqësohet nga Ministria e Financave dhe Unicredit Bank Austria A.G. për financimin e projektit mbarëkombëtar të radioterapisë”.

Të ftuar kemi përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Agjencisë Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, Zj. Milva Ekonomi që ende nuk ka mbërritur. Nuk e di nëse kemi përfaqësues të tjerë nga Ministria e Shëndetësisë

Z. Armand Shandro, Specialist në Drejtorinë e Traktateve dhe të Drejtës Ndërkombëtare në Ministrinë e Punëve të Jashtme

Znj. Elona Mistrovica, Elona Mistrovica, Specialiste në Drejtorinë e Drejtimit të Borxhit Publik, Ministrinë e Financave

Zj. Irena Malolli, Drejtore e Komunikimeve Elektronike e Postare, pranë AKSHI

Atëherë fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës: Keni vërejtje për procesverbalet nga mbledhja e kaluar? Miratohet

Pika e dytë e rendit të ditës, projektligji “Për ratifikimin e instrumenteve që ndryshojnë Kushtetutën dhe Konventën e Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacioneve (Gjenevë, 1992), të ndryshuar nga Konferenca Fuqiplotë (Guadalajara, 2010)”.

Irena Malolli – Projektligji për ratifikimin e instrumenteve që ndryshojnë Kushtetutën dhe Konventën e Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacioneve të miratuar në Konferencën Fuqiplotë të Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacioneve në 2010, është inicuar me propozim të Ministrit përgjegjës për komunikimet elektronike dhe vjen si procedurë e kërkuar nga instrumentat bazë të Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacioneve që janë kushtetuta dhe Konventa e Gjenevës 1992 e cila është ratifikuar nga Shqipëria me ligjin 8430 ligjin nr. 8430, 1998. Në bazë të Nenit 55 të Kushtetutës së Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacioneve dhe Nenit 42 të Konventës, çdo ndryshim në aktet bazë, me nënshkrimin e tyre kalojnë në procedurë aplikimi. Praktikisht, ndryshimet e miratuara në Konferencën Fuqiplotë të 2010 janë minimale. Ato prekin Nenin 28 të Kushtetutës dhe ndryshimi konsiston në njohjen e të drejtës së çdo shteti anëtar për vendosjen e kuotizacionit vjetor sipas kontributit

financiar në Bashkimin Ndërkombëtar të Telekomunikacioneve por në rast se një shtet anëtar kërkon zvogëlimin e kontributit vjetor ky zvogëlim të mos jetë më shumë se 15%; dhe ndryshimi në Nenin 33 të Konventës së Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacioneve bë një harmonizim me Nenin 28 të Kushtetutës duke bërë një përshkallëzim më të vogël në rastin kur kontributi në shtetin anëtar është më pak se dy njësi. Praktikisht vendi ynë është në kuotën minimale të pagesës së kuotizacionit vjetor, vetëm një njësi, dhe ndryshimet që bëhen në Kushtetutë dhe Konventë nuk është se kanë një impakt financiar në vendin tonë.

Arta Dade – Pyetje ose komente. Kush është dakord që të japim miratimin tonë për këtë projektligj? Miratohet.

MBYLLET MBLEDHJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 18.02.2014, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Arta Dade – kryetare e Komisionit

HAPET MBLEDHJA

Rendi i ditës:

3. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së kredisë për eksport, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë dhe përfaqësohet nga Ministria e Financave, dhe Unicredit Bank Austria A.G. për financimin e projektit mbarëkombëtar të radioterapisë”.

Arta Dade – Atëherë kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës që janë dy projektligjet e tjera që janë të lidhura me njëra tjetrën. Do ja jap fjalën përfaqësuesit të Ministrisë së Jashtme. Ndërkohë presim përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë. Ishte parashikuar që të ishte zëvendës ministre Milva Ekonomi, sepse Ministria e Shëndetësisë është ministri zbatuese.

Armand Shandro – Për sa i përket kësaj marrëveshjeje financimi Ministria e Punëve të Jashtme ka ndjekur procedurën e saj si institucioni propozues për marrëveshje ndërkombëtare. Kjo marrëveshje është brenda fushës së të drejtës ndërkombëtare publike. Kemi marrë iniciativën nga propozuesit, Ministria e Financave dhe Ministria e Shëndetësisë, dhe duke qenë se është një

marrëveshje financiare që ka të bëjë pikërisht me fushën e shëndetësisë kemi menduar ta ratifikojmë në parlament meqenëse ka efekte financiare. Marrëveshja është brenda kuadrit ligjor dhe ne si Ministri e Punëve të Jashtme jemi dakord.

Arta Dade – Faleminderid zoti Shandro. Zonja Mistrovica, përfaqësuese e Ministrisë së Fianncave

Elona Mistrovica – Ky projekt është në kuadër të një marrëveshjeje të gjerë bashkëpunimi financiar që kemi me qeverinë e Republikës së Austrisë. Është një marrëveshje kuadër 40 milionë nga e cila kanë përfituar 5 ministri. Kredia jepet në formën e kredive të buta me 0 për qind interes dhe përfitohen vetëm komisionet e menaxhimit të kredive. Ajo lëvrohet për 9 muaj, për blerjen e një pajisjeje që do t'i shërbejë pavionit të onkologjisë të Qendrës Spitalore Universitare; kap shumën 2 milionë euro dhe shlyhet brenda 6 vjetëve pa pagesë principali.

Ndërkohë, projektligji i dytë ka një përmirësim të kushteve të kësaj marrëveshjeje, ku nga 6 vjet pa pagesë principali kalohet në 7 vjet pa pagesë principali.

Arta Dade – Pyetje dhe komente? Duke qenë që kemi dhe një relacion të plotë, edhe për efektet pozitive që do të ketë edhe pas zbatimit të kësaj marrëveshjeje, unë gjykoj që ta votojmë për ta kaluar në seancën plenare.

Valentina Leskaj – Jo vetëm aq, por ka aq shumë nevojë për radioterapinë; pacientët që s'kanë bukën e gojës janë të detyruar të shkojnë në spitale private me një kosto shumë të lartë. Kështu që në këto kushte unë gjykoj që është i mirëpritur dhe ja vlen kostoja për të përmirësuar radioterapinë në Spitalin Onkologjik që po them mungon fare.

Arta Dade – Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Miratohet!

MBYLLET MBLEDHJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 18.02.2014, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Arta Dade – kryetare e Komisionit

HAPET MBLEDHJA

Rendi i ditës:

4. Projektligji “Për ratifikimin e dokumentit të ndryshimit nr. 1, të marrëveshjes së kredisë për eksport, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë e përfaqësohet nga Ministria e Financave dhe Unicredit Bank Austria A.G. për financimin e projektit mbarëkombëtar të radioterapisë”.

Arta Dade – Atëherë kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës që janë dy projektligjet e tjera që janë të lidhura me njëra tjetrën. Do ja jap fjalën përfaqësuesit të Ministrisë së Jashtme. Ndërkohë presim përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë. Ishte parashikuar që të ishte zëvendës ministre Milva Ekonomi, sepse Ministria e Shëndetësisë është ministri zbatuese.

Armand Shandro – Për sa i përket kësaj marrëveshjeje financimi Ministria e Punëve të Jashtme ka ndjekur procedurën e saj si institucioni propozues për marrëveshje ndërkombëtare. Kjo marrëveshje është brenda fushës së të drejtës ndërkombëtare publike. Kemi marrë iniciativën nga propozuesit, Ministria e Financave dhe Ministria e Shëndetësisë, dhe duke qenë se është një

marrëveshje financiare që ka të bëjë pikërisht me fushën e shëndetësisë kemi menduar ta ratifikojmë në parlament meqenëse ka efekte financiare. Marrëveshja është brenda kuadrit ligjor dhe ne si Ministri e Punëve të Jashtme jemi dakord.

Arta Dade – Faleminderit zoti Shandro. Zonja Mistrovica, përfaqësuese e Ministrisë së Fianncave

Elona Mistrovica – Ky projekt është në kuadër të një marrëveshjeje të gjerë bashkëpunimi financiar që kemi me qeverinë e Republikës së Austrisë. Është një marrëveshje kuadër 40 milionë nga e cila kanë përfituar 5 ministri. Kredia jepet në formën e kredive të buta me 0 për qind interes dhe përfitohen vetëm komisionet e menaxhimit të kredive. Ajo lëvrohet për 9 muaj, për blerjen e një pajisjeje që do t'i shërbejë pavionit të onkologjisë të Qendrës Spitalore Universitare; kap shumën 2 milionë euro dhe shlyhet brenda 6 vjetëve pa pagesë principali.

Ndërkohë, projektligji i dytë ka një përmirësim të kushteve të kësaj marrëveshjeje, ku nga 6 vjet pa pagesë principali kalohet në 7 vjet pa pagesë principali.

Arta Dade – Pyetje dhe komente? Duke qenë që kemi dhe një relacion të plotë, edhe për efektet pozitive që do të ketë edhe pas zbatimit të kësaj marrëveshjeje, unë gjykoj që ta votojmë për ta kaluar në seancën plenare.

Valentina Leskaj – Jo vetëm aq, por ka aq shumë nevojë për radioterapinë; pacientët që s'kanë bukën e gojës janë të detyruar të shkojnë në spitale private me një kosto shumë të lartë. Kështu që në këto kushte unë gjykoj që është i mirëpritur dhe ja vlen kostoja për të përmirësuar radioterapinë në Spitalin Onkologjik që po them mungon fare.

Arta Dade – Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Miratohet!

MBYLLET MBLEDHJA